



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.15/11 prot.

Datë 29.01.2024

V E N D I M
Nr. 106/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.01.2024, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 68/2024, datë 19.01.2024 për procedurën e prokurimit “E hapur e thejshtuar” me Nr. REF-92436-12-28-2023 me objekt “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme”, me fond limit 7,999,967.23 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09.01.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A
- Ankimues:** “Interlogistic” SHPK me NIPT K21605003M dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Rruga Dytësore Km 9, Godine 3 katëshe, Kashar, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A me adresë Autostrada Tiranë-Durrës, km 09, Kashar
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 19.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr.68/2024, ku vendosi:

- 1. Të pranohet pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Interlogistic” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thejshtuar” me Nr. REF-92436-12-28-2023 me objekt “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme”, me fond limit 7,999,967.23 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09.01.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.*
- 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.*
- 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.*
- 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK.*
- 5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.*

I.2. Me shkresën nr. 28/7 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën nr. 15/8 prot., datë 24.01.2024, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr.68/2024, datë 19.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thejshtuar” me Nr. REF-92436-12-28-2023 me objekt “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme”, me fond limit 7,999,967.23 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09.01.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A duke i bashëngjitur shkresës dhe shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit në zbatim të vendimit më sipër të KPP-së.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 28/7 prot., datë 23.01.2024, protokolluar me tonën nr. 15/8 prot., datë 24.01.2024, autoriteti kontraktor, njofton se ka zbatuar vendimin nr.68/2024, datë 19.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “E hapur e thejshtuar” me Nr. REF-92436-12-28-2023 me objekt “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme”, me fond limit 7,999,967.23 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09.01.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A duke i bashëngjitur shkresës

dhe shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit në zbatim të vendimit më sipër të KPP-së.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën për modifikimin e dokumenteve të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, e cila është në përputhje me vendimin nr. 68/2024, datë 19.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.3. Sa më sipër, Komisioni konstaton se autoriteti kontraktor ka zbatuar vendimin nr. 68/2024, datë 19.01.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi pasi ka publikuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) shtojcën me ndryshimet në dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e vendimit nr. 68/2024, datë 19.01.2024 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E hapur e thejshtuar” me Nr. REF-92436-12-28-2023 me objekt “Blerje materiale kancelarie dhe te ngjashme”, me fond limit 7,999,967.23 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 09.01.2024 nga autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Durrës Sh.A.
 2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

